



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-149

Prishtinë, më 17 mars 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 MARS 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Ahmet Isufi, Myzejene Selmani, Sreten Ivanović dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 mars 2014,
2. Vazhdimi i seancës plenare, të filluar më 13 mars 2014,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 mars 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 mars 2014.

2. Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 13 mars 2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të mërkurën, më 19 mars 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
13. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
14. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
15. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, dhe
16. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Mediave.

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës u është shpërndarë deputetëve më 14 mars 2014 dhe është ngarkuar Komisioni për Legjislacion për ta shqyrtuar atë dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Ai theksoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 56, paragrafi 1 “Shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune dhe as më vonë se katër javë pune nga dita e shpërndarjes së tij”.

Ai tha se shqyrtimi i parë i këtij projektligji mund të bëhet pas datës 28 mars 2014.

Ndërsa, për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me dy të tretat (2/3) e deputetëve të pranishëm në mbledhje plenare. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetues së Republikës së Kosovës dhe me standardet evropiane.

Lidhur me Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, diskutuan: Ismet Beqiri dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit vendosi që nëse Komisioni Funkcional e procedon raportin me rekomandime deri të enjten më 20 mars 2014, Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës i propozohet seancës për shqyrtim në parim, për të cilin vendos seanca, sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit.

* * *

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 20 mars 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,*
- 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,*

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013

Për raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013 diskutuan: Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, nxori këtë:

V e n d i m

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile

Kryesia, pas diskutimit, pikën e lartpërmendur e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 27 mars 2014.

3. Kërkesa e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për radhitjen në shqyrtim të dytë në seancë plenare të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Për pikën e lartpërmendur diskutuan: Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Adem Grabovci, Albulena Haxhiu, Ahmet Isufi dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit, projektligjin e lartpërmendur e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

4. Procedimi i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës

Kryesia, pas diskutimit lidhur me projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Projektligji për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës, të propozuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së si Komision Funkcional që ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

5. Njoftimi i katër deputetëve lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Beograd, prej 3-4 mars 2014

Kryesia u njoftua me vizitën zyrtare të katër deputetëve të Kuvendit: Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Hashim Dëshishku dhe Ali Sadriu, të realizuar në Beograd, prej 3-4 mars 2014.

Pikat shtesë:

1. Procedimi i Projektligjit për lojërat e fatit

Kryesia, pas diskutimit lidhur me projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për lojërat e fatit, të hartuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-në, në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.

2. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj

Për pikën e lartpërmendur diskutuan: Jakup Krasniqi, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Ahmet Isufi dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit lidhur me vendimin e lartpërmendur, nxori këtë:

V e n d i m

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa si Komision FunkSIONAL që ta shqyrtojë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e vendimeve të gjykatave për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale